



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0247**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Isa Hasani- Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË, kundër Njoftimit e kontratës ose me dokumentet e tenderit të KOMUNA E GJAKOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi – asfaltimi i rrugës Lipovec - Goden me numër të prokurimit 632-23-12953-5-2-1, me 25/06/2024, mori:

## **Vendim**

1. Aprovohen, si pjesërisht të bazuara ankesat e OE " PE -VLA-KU " Sh.p.k, dega Kosovë, me nr. 2024/0247, e datës 21/03/2024, kunder vendimit të autoritetit kontraktues- Komuna Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit” Ndërtimi – asfaltimi i rrugës Lipovec – Goden” me numër të prokurimit; 632-23-12953-5-2-1.
2. Mbetet në fuqi ”Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues”, i datën 05.03.2024 - Komuna Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit” Ndërtimi – asfaltimi i rrugës Lipovec – Goden” me numër të prokurimit; 632-23-12953-5-2-1 me të dhënat si në pikën 1. të dispozitivit
3. Lejohet kthimi i tarifës për ankesë, në vlerën e deponuar për paraqitjen e ankesës, Operatorit ekonomik OE " PE -VLA-KU " Sh.p.k, dega Kosovë, sipas nenit 31.4. OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për tërheqje të depozitës për sigurim të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Arsyetim**

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 22.11.2023, Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ndërtimi - asfaltimi i rrugës Lipovec - Goden”, Nr. i prokurimit - 632-24-12953-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-180-521”. Ndërsa me datën 05.03.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku është rekomanduar për kontratë GOE “JV: “Marisa” Sh.p.k & NNSH Vaakal”

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës pune dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 243,160,95€

Me 07.03.2024, “Pe -Vla-Ku Sh.P.K.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 12.03.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 21.03.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Pe -Vla-Ku Sh.P.K.” me nr. 247/2024 për lidhur me aktivitetin “Ndërtimi - asfaltimi i rrugës Lipovec - Goden”, Nr. i prokurimit - 632-24-12953-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-180-521”.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Pe -Vla-Ku Sh.P.K.” janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): “Në kërkesat e dosjes së tenderit të paraqitura nga Autoriteti Kontraktues: Komuna e Gjakovës, tek kërkesat e përshtatshmes, pjesa Dëshmitë e kërkuara dokumentare kërkohen: Vërtetimi i ATK për tre (3) mujorin e fundit, Vërtetimi i gjykatës për kompaninë, Vërtetimi i gjykatës për drejtuesit e kompanisë. Këto dokumente në momentin e aplikimit mund edhe të mos dorëzohen nga aplikuesit, por që këto dokumente kërkohen në momentin e shpalljes fitues të OE ose konzerciumit dhe që konzerciumi i shpallur fitues nuk i ka në dosje të saj edhe pas shpalljes fitues nga AK: Komuna e Gjakovës Vetëm lideri Marisa ShPK e ka Vërtetimin e Gjykatës, ndërsa Vërtetimin e ATK-se dhe Vërtetimin e Gjykatës për drejtuesit nuk i kanë dorëzuar as njeri anëtarë i konzerciumit. Në pike të arsyetimit AK: Komuna e Gjakovës ka thënë që këto janë dorëzuar në kopje fizike nga anëtarët e konzerciumit si dhe Vërtetimi i gjykatës për pronarët që nuk është nën hetime nuk është kërkuar nga AK.”

Pretendimi i dytë (II) : “Plani dinamik i konzerciumit mungon, nuk është e paraqitur në dosje të tenderit,por Aneksi 6.1 Afati i Implementimit dhe periudha Garantuese është i plotësuar nga lideri i konzerciumit “ Marisa” Sh.P.K, dhe ka paraparë afatin e implementimit të projekti për katër (4) dite. Vlen të ceket së për katër (4) dite nuk mundet që të bëhet as mobilizimi për fillimin e punimeve e le më të përfundohet projekti. Nuk e ka parapare kohen minimale të përfundimit të projektit, mirëpo katër (4) dite është mjaftë jo serioze që të marrët parasysht kjo oferte Dhe përsëri AK: Komuna e Gjakovës e mbron vendimin e tij, duke thënë që nuk është kërkuar afat prag por që meqë Operatori Ekonomik ka prezantuar plan dinamik më të shkurtër, në bazë të formulës për tenderin ekonomikisht më të favorshëm është rekomanduar për kontratën.”

Pretendimi i tretë (III) : “Konzerciumi i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit, saktësisht tek kapaciteti ekonomik dhe financiar ku kërkesë ka qenë “Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar me një vlerë të përgjithshme prej së paku 524,000.00 €, në 3 (tri) vitet e fundit,2020, 2021 dhe2022 në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 51% të vlerës së qarkullimit”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “Deklaratat Tatimore Vjetore të Tatimit në të Ardhura ose Korporata të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për 3 (tri) vitet e fundit (kopje)”. Kërkesa e lartcekur nga Autoriteti Kontraktues: Komuna e Gjakovës specifikon qartë se lideri i grupit duhet ti posedoj 51% të qarkullimit, ndërsa lideri i grupit sipas marrëveshjes së konzerciumit është “Marisa” Sh.P.K, ky nuk ka prezantuar në ofertë asnjë dëshmi në lidhje me qarkullimin bankar dhe as qarkullimi nga AKT-ja, por ka paraqitur vetëm Deklaratat Tatimore Vjetore. Ndërsa anëtarë tjetër i konzerciumit “NNSH Vaakal” ka paraqitur qarkullimin bankar por nuk ka paraqitur

deklaratat tatimore vjetore, dhe si i tillë të njëjti janë të papërgjegjshëm, pasi që nuk e plotëson kërkesën e lartcekur, për qarkullimin e përgjithshëm që është kërkuar nga AK: Komuna e Gjakovës. Përsëri AK: Komuna e Gjakovës e mbron pretendimin e tij se kjo kërkesë është plotësuar nga konzerciumi i rekomanduar për dhënie të kontratës.”

Pretendimi i katërt (IV) : “Në dosje të tenderit të konzerciumit, saktësisht në listën e paraqitur të stafit profesionale janë inxhinierë të cilët nuk kanë kontrata pune as të rregullta dhe as mbi vepër nuk kanë referenca pune dhe me e rënda janë dosje të përdorura nga dy kompani të cilat janë pjesëmarrëse në këtë aktiviteti të prokurimit. Ing. Komunikacionit Uran Mulaj dhe Egzon Tofaj nuk e kanë kontrata të punës, ndërsa ing. Suad Bushit i mungojnë referencat nga punët e mëparshme. Haki Mehmeti gjeodet i licencuar - ky gjeodet është gjeodet me diplome bachelor i cili nuk i plotëson kriterin. Florent Retkoceri – Gjeodet i licencuar, Uran Mulaj – Ing. Komunakicaionit Suad Bushi – Ing. Emergjencav. Këta inxhinierë janë inxhinierë të cilët janë edhe në listën e stafit profesional të kompanisë N.SH.T “Viktory Com”. Vlen të ceket se kompania N.SH.T “ViktoryCom” është pjesëmarrëse në këtë aktivitet të prokurimit gjë e cila e bënë që të jetë në kundërshtim me ligjin dhe me rregullat e prokurimit që dy kompanitë pjesëmarrëse të kenë të njëjtin stafe profesionale. Kjo gjë nuk është marre në konsiderate nga AK: Komuna e Gjakovës dhe është shume për tu habitur se si autoriteti kontraktues e bënë një lëshim të këtillë. Gjithashtu në arsyetimin evendimit të tij, AK: Komuna e Gjakove thekson qe Pretendimi jone që dy kompanitë pjesëmarrëse në këtë projekt (Marisa dhe Victory Com), kanë të njëjtin stafe profesionale dhe qe kjo përmban shkelje ligjore, nuk qëndron, sepse vetëm njeri prej tyre është rekomanduar për kontrate .Kjo shkelje e AK: Komunës se Gjakovës është skandaloze, diskriminuese dhe është shumë për tu habitur se si lejohet që dy kompani pjesëmarrëse të kenë staf, dhe makineri të njëjta.”

Pretendimi i pestë (V): “ Në dosje të tenderit tek kërkesat mbi mundësin teknike dhe /ose profesionale, pika 9.1 &9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar Aneksi 7, pajisje teknike dhe stabilimente. Gjithashtu lista e paraqitur për mjetet, stabilimentet, dhe pajisjet teknike nga konzerciumi për makineritë është shumë e mangët dhe është përsëri në kundërshtim me procedurat e prokurimit. Pasi që edhe këtu vërejmë që makineritë e njëjta janë të përdorura nga dy kompanitë pjesëmarrëse në këtë projekt. Makinaria të marruara me qira nga konzerciumi, janë makineritë të cilat i kanë në dosje të tyre edhe kompania N.SH.T Viktory Com" Përsëri po e cekim se edhe kjo kompani është pjesëmarrëse në këtë procedure të prokurimit dhe që të njëjta makineri i kanë dosje të saj. Si kamionët që janë pjese e kontratës së qeras në mesë të Marisa SH.P.K dhe .SH.T Viktory Com" Gjithashtu në listën e pajisjeve të saj ka paraqitur edhe makineri të tjera të që ka marrë me qira por që kontratat e tyre nuk janë në dosje si kontrata e Murselit Shpk. Edhe për këtë pjese arsyetimi i Autoriteti Kontraktues ka qenë i njëjti si në fillimi. Prandaj, duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura, shihet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i pa qëndrueshëm dhe njëkohësisht është favorizim i hapur kundrejt OE të rekomanduar për kontratë. Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet qe u cekën më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë. Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që “Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse”, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore. Autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Pe -Vla-Ku Sh.P.K.” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Neni 1, 7, 27, 57, 59, 60, 68, 69, 72 të LPP-së si dhe Neni 2, 26, 27, 41 i Rregullores dhe Udhëzuesit Prokurim Publik. Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të marrë: Vendim të Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE PE -VLA-KU SH.P.K. Dega në Kosovë si dhe të Anullohet, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në Rivlerësim, Detyrohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe në konform dispozitave të LPP-së.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim:

“Operatori ekonomik PE -VLA-KL SH.P.K. DEGA NË KOSOVË me dt.07.03.2024, ka parashtruar kërkesës për shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi - asfaltimi i rrugës Lipovec - Goden”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-12953-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-180-521. Autoriteti Kontraktues Komuna c Gjakovës, me datë 12.03.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:1.Pretendimi juaj se është rekomanduar për kontratë Grupi Operatoreve Ekonomik me çmim më të lartë nuk qëndron. sepse kriter i dhënies ka qenë tenderi ekonomikisht me i favorshëm e jo çmimi më i lirë; 2.Pretendimi juaj lidhur me vërtetimet e gjykatës dhe ATK-së. të Grupit të Operatorëve Ekonomik të rekomanduar për kontratë nuk qëndron, sepse të njëjtit kanë dorëzuar në kopje fizike me dt. 16.01.2024, kur ju është kërkuar me Letrën standarde të dt. 11.01.2024. të cilat janë ende validë përveç Vërtetimit të gjykatës të OE “MARISA” c cila i është kërkuar edhe njëherë, sepse i ka skaduar afati. Sa i përket vërtetimit të gjykatës për pronarin se nuk është nën hetime. sqarojmë se Autoriteti kontraktues nuk e ka kërkuar; 3.. Sa i përket planit dinamik, Autoriteti kontraktues nuk ka caktuar prag dhe meqë Operatori ekonomik ka prezantuar planin dinamik më të shkurtër, në bazë të formulës për tenderin ekonomikisht më të favorshëm është rekomanduar për kontratë, prandaj edhe ky pretendim i juaji nuk qëndron; 4.Pretendimi juaj par qarkullimin financiar, nuk qëndron. sepse edhe vetë keni deklaruar se lideri i grupit ka prezantuar si dëshmi Deklaratën Tatimore Vjetore siç ishte kërkuar në FDT-së cila e mbulon tërë anëtarë e konzorciumit); 5.Lidhur me numrin e punëtorëve të kërkuar, pretendimi juaj nuk qëndron sepse Grupi i Operatoreve Ekonomik i rekomanduar për kontratë. ka prezantuar numrin e punëtorëve dhe stafit profesional siç është kërkuar në FDT-c; 6.Pretendimi juaj se dy kompani pjesëmarrëse në këtë projekt ( Marisa dhe Viktory Com), kanë të njëjtin staf profesional dhe se kjo përbën shkelje ligjore, nuk qëndron, sepse vetëm njëri prej tyre është rekomanduar për kontratë; 7.Pretendimi juaj se lidhur me stafin profesional dhe emrin e punëtorëve nuk qëndron, sepse Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime shpesh me nenin 72 të LPP-së, të cilat Grupi Operatorëve Ekonomik i ka sjellë dhe me këtë ka plotësuar kërkesat c Autoritetit kontraktues në FTD-së. 8.Pretendimi juaj se dy kompani pjesëmarrëse në këtë projekt ( Marisa dhe Viktory Com), kanë të njëjtin makineri dhe se kjo përbën shkelje ligjore, nuk qëndron, sepse vetëm njëri prej tyre është rekomanduar për kontratë; 9.Pretendimi juaj se Grupi Operatoreve Ekonomik i rekomanduar par kontratë, në listën e pajisjeve ka paraqitur edhe makineri tjera të marrura me qira por që kontratat e tyre nuk janë në ofertë, nuk qëndron, sepse Grupi Operatoreve Ekonomik i rekomanduar për kontratë( pajisjet c të dy anëtarëve të konzorciumit), ka plotësuar kërkesat e Autoritetit kontraktues siç është kërkuar në FDT- së. Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane me lart ka vendosur si në dispozitiv.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 22/03/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 247/2024, ndërsa me datë 04/04/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/247 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale AK Nuk Pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues ndërsa OE ka deklaruar se Pajtohet me mendimin e ekspertit.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Pe -Vla-Ku Sh.P.K.” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/247 kanë vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): “Pretendimi i paraqitur nga: OE - PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NËKOSOVË është pretendim i BAZUAR, pasi që pas kontrollit në dokumentacionin e kompanisë dhe shtylla e veçantë ku ngritën Dëshmitë e pranueshmerisë, konzorciumi i paraqitur si fitues nga Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës nuk ka dokumentacionin e përcaktuar në Formularin e Dosjes se Tenderit, respektivisht dokumentacionin e lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe Vërtetimi nga Gjykata. Këto dokumente janë obligative për t’u paraqitur nga ana të gjithë anëtarët e konzorciumit. Arsyetimi nga ana e AK gjatë trajtimit të kërkesës për rishqyrtim se këto dokumente janë sjellë në formë fizike nga GOE është i mangët dhe jo bindes as për OE ankimes e as për mua si Ekspert shqyrtues sepse në rastin që këto dokumente AK do t’i posedonte si formë fizike (duhej t’i ngarkonte se bashku me Vendimin për rishqyrtim) pasi që këto dokumente nuk llogariten si sekret afarist”.

Konstatimi i dytë (II) :“Pretendimi i paraqitur nga: OE - PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË është pretendim PJESËRISHT I BAZUAR, sepse: katër ditë për realizimin e një projekti 262039.35 euro (vlera e parashikuar) është vlerësim jo real (pasi që Autoriteti Kontraktues të Kriteret e dhënies – te nen kriteri Afati me i shkurt i implementimit nga data e nënshkrimit të kontratës deri në max. 630 ditë) ndërsa tek Kushtet e Veçanta të Kontratës ka përcaktuar: pika 17.2. Kontrata planifikohet të përfundoj brenda 12 muajsh, në bazë të cilës periudhë edhe do të bëhen pagesat, gjë që është në kundërshtim të përcaktuar nga vet nen kriteret e dhënies nga Autoriteti Kontraktues dhe tani poenton me 30 pikë një Operator Ekonomik që do t’i realizoi punimet për 4 ditë, i bije se si Autoritet Kontraktues kanë dështuar në planifikim kohor dhe se nen kriteri ishte i paqartë për Operoret Ekonomik”. Operatori Ekonomik ka ngritur pretendimin edhe për planin dinamik të cilin nuk e ka dorëzuar OE i rekomanduar për kontratë, por që ky kriter nuk ishte pjesë e Dosjes se Tenderit por ishte vetëm në Kushtet e Veçanta të Kontratës i cili plan mund të dërgohet gjatë implementimit të kontratës.”

Konstatimi i tretë (III) : “Pretendimi i paraqitur nga: OE - PE -VLA-KU Sh.P.K. Dega në Kosovë është pretendim I PABAZUAR, pasi që gjatë trajtimit të dokumentacionit për GOE e rekomanduar për kontratës “Lideri i paraqitur në konzorcium” Marisa SHPK tek follderi 2.0 Vërtetimet e ATK-së ka paraqitur CD - Formulari i Deklarimit Vjetor dhe Pagesës Për tatimin Në Të Ardhurat E Korporatave e Administratës Tatimore të Kosovës për vitet e kërkuara në Formularin e Dosjes se Tenderit (Respektivisht 2020, 21 dhe 22) dhe qarkullimi financiar i paraqitur nga kjo kompani tek shtylla 60 – të ardhurat bruto plotësojnë 51% të vlerës se kërkuar për qarkullim.”

Konstatimi i katert (IV) ; “Pretendimi i paraqitur nga: OE - PE -VLA-KU SH.P.K. Dega në Kosovë është pretendim I Bazuar, pasi që: 1. z. Uran Mulaj, bazuar në CV e tij nuk ishte i punësuar asnjëherë në kompaninë e rekomanduar për kontratë “as në Marisa e as në Vaakal” dhe si e tillë Autoriteti Kontraktues nuk ka mundur t’i kërkojë dokumentacion shtesë “Kontratë të punës ose parakontratë” pasi që nuk ka asnjë indikator që mat se dokumentacioni i paraqitur nga kompania është dokument para datës së dorëzimit të dokumentacionit ofertës së paraqitur tek autoriteti Kontraktues. Pretendim i bazuar. 2. z. Egzon Tofaj, ka paraqitur Kontratën mbi vepër në emër të projektit, ndërsa diploma e tij nuk i plotëson kushtin e kërkuar - b.) Një inxhinier i diplomuar apo master i komunikacionit me 5 vjet provoj pune pas diplomimit - Pretendim i bazuar. 3. z. Suad Bushi, nuk ka paraqitur referencat nga punët e kaluara (pasi që ky kriter nuk ishte i paraqitur në Formularin e Dosjes se Tenderit). - Pretendim i pabazuar. 4. z. Haki Mehmeti – ka paraqitur Licencën “Gjeodet i Licencuar” dhe në këtë formë ka plotësuar kriterin e përcaktuar në

Formularin e Tenderit. - Pretendim i pabazuar. Sqarim lidhur me stafin: Autoriteti Kontraktues, ka përdorur nenin 72 të Ligjit të Prokurimit Publik, në kundërshtim me parimet bazë të këtij neni (as dokumentacioni i z. Mulaj e as dokumentacioni i z. Tofaj) nuk mund të kërkohen pasi që asnjëri prej tyre nuk mund të vërtetohet që ekziston para datës së dorëzimit të ofertave, dokumentacioni i z. Mulaj, është dokumentacion faktik i cili argumentohet se i njëjti nuk ishte asnjëherë i ngarkuar me punë të kompanitë e rekomanduara dhe se Kontrata mbi vepër e paraqitur me sqarime shtesë është dokument i pavlefshëm pasi që kompanitë mund të hartojnë Kontrata mbi vepër sa here që atyre ju nevojitet. Ndërsa dokumentacioni i z. Egzon Tofaj, është faktik diploma e tij është me e re se 5 vite. Lidhur me pretendimin se stafi i paraqitur nga Marisa është staf i kompanisë Victory COM është pretendim i PABAZUAR, pasi që ligji specifikon “Kompanitë” nuk mund të ofertojnë se bashku dhe ndaras në një aktivitet të prokurimit dhe duhet të s’kualifikohen por në rastin kur stafi i kompanisë se njëjtë është edhe të një kompani tjetër, dispozitat e LPP-se dhe rregullores nuk e ndalojnë këtë veprim pasi që vetëm njëra prej tyre mund ta marr kontratën dhe stafi do të jetë i punësuar vetëm te njëra kompani.”

Konstatimi i pestë (V) : “Pretendimi i paraqitur nga: OE - PE -VLA-KU Sh.P.K. Dega në Kosovë është pretendim I PABAZUAR, pasi që mjetet e paraqitura edhe pse janë të kompanisë tjetër të njëjtat do të shfrytëzohen vetëm nga njeri operator (ai i cili do e marr kontratën). Krejt në fund, Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni 59. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, Nenin 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi ku ka shpallur fitues Grupin e Operatoreve Ekonomik Marisa & Vaakal ani pse të njëjtit nuk i kanë plotësuar kushtet e përcaktuara në Formularin e Tenderit, në këtë formë i propozoi Panelit Shqyrtues të OSHP-së aprovimin e ankesës si të bazuar dhe kthimin e lëndës në rivlerësim.”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit” Ndërtimi – asfaltimi i rrugës Lipovec – Goden” me numër të prokurimit; 632-23-12953-5-2-

1. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues " PE -VLA-KU " Sh.p.k, dega Kosovë” i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Paneli Shqyrtues lidhur me vlersimin e pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, i mbështet pjesërisht vlersimet e raportit të ekspertit shqyrtues pjesërisht por nuk e mbështet rekomandimin përfundimtar dhe në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues " PE -VLA-KU " Sh.p.k, dega Kosovë janë pjesërisht të bazuara.

Paneli shqyrtues konstaton se Eksperti shqyrtues i ka vlersuar të gjitha pretendimet ankimore të OE ankues " PE -VLA-KU " Sh.p.k, dega Kosovë,të cilat sipas vlersimit përfundimisht sjellin rezultatin për aprovimin e pjesërishtëm të ankese se OE ankues, por Paneli shqyrtues nuk e mbështet rekomandimin përfundimtar të ekspertit shqyrtues për kthimin e lëndës në rivlersim, pasi është në kundërshtim me vete gjetjet dhe vlersimit të pretendimeve ankimore, të cilat do të paraqesim në analizimin e fakteve dhe provave të këtij aktiviteti dhe të cilat janë bazë e pamjaftueshme për ndryshimin e rezultatit përfundimtar-vendimit të autoritetit publik.

Paneli shqyrtues nga raportit i ekspertit shqyrtues vrene se pala ankuese operatori ekonomik " PE -VLA-KU " Sh.p.k, dega Kosovë, ka paraqitur shtatë(7) pretendime ankimore lidhur me aktivitetin e prokurimit e të cilat janë trajtuar nga eksperti shqyrtues, Paneli vren se eksperti i ka vlersuar si të pabazuara pesë(4) pretendime ankimore, ndersa vetem tre (3) i ka vlersuar si të bazuara.

Pretendimi pare ankimor, i vlerësuar si bazuar sipas ekspertit shqyrtues, ka të bëjë kundër Autoriteti kontraktues, tek kërkesat e përshtatshmes, pjesa Dëshmitë e kërkuara dokumentare: Vërtetimi i ATK për tre (3) mujorin e fundit, Vërtetimi i gjykatës për kompaninë, Vërtetimi i gjykatës për drejtuesit e kompanisë, këto dokumente kërkohen në momentin e shpalljes fitues OE se rekomanduar i shpallur fitues nuk i ka dorëzuar të gjitha pjesërisht në sistem, Paneli shqyrtues ket pretendim ankimor e vleron si të pabazuar, dhe i falë besimin e provës Autoriteti kontraktues Komunes se Gjakovës e cila në raportin e ekspertit shqyrtues ka deklaruar në sistem e-prokurimi si në vijim;” *Pretendimi I OE Ankues ka aluduar se vërtetimet e ATKS-së Gjykatës se gjëja janë sjellë vetëm nga lideri. Ky pretendim nuk qëndron sepse ky grup i OE ishte fitues dhe AK-ja i kishte sjell vërtetimet e lartshënuar. Ka pas kerkës për rivlerësim dhe lënda është kthyer në rivlerësim pas rivlerësimit prape ky grup i OE ka dal fitues . Më datë 28.02.2024 AK-ja ka kërkuar vërtetimet e AKT-së dhe Gjykatës vetëm liderit të grupit pas qe se anëtarët e grupi vërtetimet i kane sjellë herën e pare dhe kishin afat valid”.*

Pretendimi i tretë ankimor, i vlerësuar si bazuar sipas ekspertit shqyrtues, ka të bëjë me iUran Mulaj, inxhinier i komunikacionit, Paneli shqyrtues ket pretendim ankimor e vleron si të pabazuar, dhe i falë besimin e provës Autoriteti kontraktues Komunes se Gjakovës e cila në raportin e ekspertit shqyrtues ka deklaruar në sistem e-prokurimi si në vijim; “*OE Ankues ka kontestuar stafin profesional. Ky pretendim nuk qëndron sepse me: 26.02.2024 AK-ja ka kërkuar sqarime shprese komformë nenit 72 pika 2 dhe 3 të LPP-së, e po ashtu konformë Udhëzuesit për Prokurim 001/2023, ku citohet (cv-ja e kërkuar nuk është dorëzuar, mund të kërkohet informata sqaruese për Inxhinierin të komunikacionit z. Uran Mulaj , të cilin e ka prezantuar në listën e stafit profesional por nuk sjell diplomën dhe CV-në “.*

Pretendimi i katër ankimor, i vlerësuar si bazuar sipas ekspertit shqyrtues, ka të bëjë me i Egzon Tofaj, inxhinier me arsyetimin e ekspertit se “diploma e tij është me e re se 5 vite,Paneli konstaton se në dosjen e ofertës të dokumnetacioni stafi profesional vrehet se Egzon Tofaj,ka kryer studimet e masterit në fushen e komunikacionit, me 27.12.2018, ndersa tenderi është publikuar me 20.11.2023, cka le të nenkuptohet se vetem me diplomën e masterit ai ka 4 vite 10 muaj e 13 dite, pa e llogaritur dhe kohën kur ka kryer studimet Bachelor në fushen e komunikacionit në vitin 2012 sic vrehet në cv- etij , eksperti shqyrtues ka deshtuar në verifikimin e fakteve andaj dhe ka nxjerr vlersimin e gabuar.

Paneli shqyrtues se po ashtu duke u bazuar nga të gjitha faktet, arsyet dhe gjendjen faktike që u përshkrua si më sipër, konstaton se Autoriteti kontraktues duke i vlersuar tiparet kryesore të LPP-së, që janë ekonomociteti, efikasiteti dhe kursimi i buxhetit të shtetit, ka rekomanduar për kontratë ofertën e OE, e

cila e është ekonomikisht me e favorshme.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës ka gjetur se ankesa është pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna Gjakovë lidhur me aktivitetin “Ndërtimi - asfaltimi i rrugës Lipovec - Goden”, Nr. i prokurimit - 632-24-12953-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-180-521”, Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar konform dispozitave ligjore të LPP, pasi që AK ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese ndaj OE pjesëmarrës, duke u bazuar në dokumentacionin e prezantuar dhe dëshmitë dëshmuese me pas ka rekomanduar OE me ofertën më të favorshme. Paneli Shqyrtues vlerëson se vlerësimi i tenderit është kryer sipas kërkesave të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dosjes së tenderit. Andaj, Paneli Shqyrtues vlerëson se AK me të drejt ka shpërblyer OE e rekomanduar pasi që ka përmbushur gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit si dhe ka qenë tenderi me i përgjegjshëm me çmim me të favorshëm.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj” lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.





Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Isa Hasani**

*Hasani*

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË**
- Arkivës së OSHP-së: